



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 15312021  
Nr.i fq/Br.str./Nr.pg. 021021  
Data/Datum/Date: 02/02/21



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## OPINION

### I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Ex officio 711/2020

në lidhje me

*vendosjen e kamerave të trupit tek zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës*

#### Drejtar:

- Z. Samedin Mehmeti, Drejtor i përgjithshëm i Policisë së Kosovës

Prishtinë, 2 shkurt 2021

## QËLLIMI

1. Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut në lidhje me çështjen e ngritur nga Policia e Kosovës, që ka të bëjë me vendosjen e kamerave të trupit tek zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës.

## BAZA LIGJORE

2. Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nen 18, paragrafi 3, përcakton: “*Avokati i Popullit mund t'i këshillojë dhe t'u rekomandojë autoritetet e Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës.*”

## PËRSHKRIMI I RASTIT

3. Avokati i Popullit, në bazë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, në takimin e mbajtur më 3 dhjetor 2020, është takuar me përfaqësues të Policisë së Kosovës, me ç’ rast është diskutuar për projektin e Policisë që ka të bëjë me vendosjen e kamerave të trupit tek zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës.
4. Në këtë takim është kërkuar nga Avokati i Popullit që përmes një opinioni të shprehë pikëpamjet e tij shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut në lidhje me çështjen e vendosjes së kamerave të trupit tek zyrtarët policorë.

## SFONDI LIGJOR

5. Kushtetuta e Republikës së Kosovës:

- Neni 36 [E Drejta e Privatësisë] përcakton:

“1. Çdokush gjëzon të drejtën që t'i respektohetjeta private dhe familjare, pacenueshmëria e banesës dhe fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe e komunikimeve të tjera.

2. Kontrolllet e cilësdo banese ose cilitdo objekti privat, që mendohet se janë të domosdoshme për hetimin e krimtit, mund të bëhen vetëm deri në shkallën e domosdoshme dhe vetëm pas miratimit nga ana e gjykatës, pas shpjegimit të arsyeve pse një kontroll i tillë është i domosdoshëm. Shmangia nga kjo rregull lejohet, nëse është e domosdoshme për arrestim të ligjshëm, për mbledhjen e provave që ka rrezik të humbasin ose për mënjanimin e rrezikut të drejtpërdrejtë dhë serioz për njerëzit dhe për pasuri, në mënyrën e përcaktuar me ligi. Gjykata duhet që të miratoj veprimet e tillë në mënyrë retroaktive.

3. Fshehtësia e korrespondencës, telefonisë dhe komunikimit tjeter, është e drejtë e pacenueshme. Kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm përkohësisht, në bazë të vendimit gjyqësor, nëse është e domosdoshme për ecurinë e procedurës penale ose për mbrojtjen e vendit, në mënyrën e parashikuar me ligi.

4. Secili person gjëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale. Mbledhja, ruajtja, qasja, korrigimi dhe shfrytëzimi i tyre rregullohet me ligi.”

6. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

- Neni 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare] përcakton:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”

7. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë:

- Neni 2 [Parimet udhëzuese], paragrafi 1, nënparagrafët 1.3, 1.4 dhe 1.5, përcakton:  
“1. Veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

[. . .]

1.3. paanshmëria dhe neutraliteti lidhur me bindjet dhe pikëpamjet politike të personave,

1.4. integriteti, ndershmëria dhe përgjegjësia në shërbimin publik,

1.5. transparenca - ofrimi i informatave për qytetarët dhe të qenit të hapur ndaj publikut.”

- Neni 10 [Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë], paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 – 1.7, përcakton:

“1. Detyrat e përgjithshme të policisë janë të:

1.1. mbroj jetën, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat,

1.2. mbroj të drejtat dhe liritë themelore të të gjithë personave,

1.3. parandaloj rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike,

1.4. parandaloj dhe t'i zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre,

1.5. hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre,

1.6. mbikëqyrë dhe kontrolloj sigurinë në komunikacion,

1.7. menaxhoj dhe kontrolloj kufirin shtetëror,

[. . .].”

- Neni 22 [Kontrolli parandalues], paragrafi 2, përcakton:

“2. [. . .] Kontrolli mund të përfshijë përdorimin e mjeteve teknike [theks i shtuar] dhe të tjera [. . .].”

- Neni 31 [Mbledhja, ruajtja, procedimi, analizimi, përdorimi dhe fshirja e të dhënavë], paragrafi 2, përcakton:

“2. Mbledhja, ruajtja, përdorimi dhe transferimi i të dhënavë personale bëhet në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënavë personale.”

8. Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor:

- Neni 8 [Organet për autorizim, mbikëqyrje dhe rregullim të trafikut], paragrafi 1, përcakton:

“1. Mbikëqyrjen dhe rregullimin e trafikut, të mjeteve, të shoferëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në trafikun rrugor e kryejnë pjesëtarët e policisë.”

9. Ligji nr. 04/L-072 për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror:

- Neni 5 [Organi i cili e kryen kontrollin kufitar], paragrafi 2 përcakton:

*“2. Punët që kanë të bëjnë me kontrollin kufitar i kryen policia kufitare ne kuadër te polisë së Republikës se Kosovës, (ne tekstin e mëtejmë: policia kufitare).”*

## ANALIZA JURIDIKE

10. Avokati i Popullit vëren se Policia e Kosovës vepron në bazë të ligjit bazik (Ligji nr. 04/L-076 për Policinë), e po ashtu ka kompetenca edhe sipas ligjeve të tjera, veçanërisht: Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-069 për Ndryshtimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor; Ligji nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-214 dhe me Ligjin nr. 06/L-013.

11. Avokati i Popullit thekson se sipas bazës ligjore, Polisë së Kosovës i lejohet përdorimi i masave teknike, me qëllim të kryerjes së aktiviteteve policore që bien në kompetencën e tyre.

12. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vëren se veprimet e Polisë së Kosovës mbështeten në parimin e paanshmërinë, neutralitetit, integritetit, ndershmërisë, përgjegjësisë në shërbimin publik si dhe transparencës.

13. Krejt në fund, Avokati i Popullit vlerëson se përdorimi i mjetave teknike, të cilat janë rezultat i garancive ligjore, nuk duhet të konsiderohen si pengesë në arritjen e një qëllimi legjitim, aq më tepër kur veprimet e tilla e ngritin nivelin e paanshmërisë, të transparencës, të integritetit, si dhe të përgjegjësisë në shërbimin publik të Polisë së Kosovës.

## PËRFUNDIM

14. Avokati i Popullit ka analizuar çështjen e ngritur nga Policia e Kosovës, që ka të bëjë me projektin e Polisë lidhur me vendosjen e kamerave të trupit tek zyrtarët policorë të Polisë së Kosovës.

15. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit thekson se Policia e Kosovës, si institucion kompetent për mbrojtjen e rendit në Republikën e Kosovës, ushtron veprimitarinë e saj sipas legjislacionit në fuqi.

16. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se është shumë me rëndësi që veprimitaria e zyrtarëve policorë të jetë e paanshme, me integritet, transparente dhe përgjegjëse në ushtrimin e mandatit që buron nga legjislacioni në fuqi.


17. Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit mirëpret çfarëdo veprimi nga Policia e Kosovës, i cili është i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, e që për rezultat ka ngritjen e nivelit të paanshmërisë, të integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë në ofrimin e shërbimeve publike të polisë.

18. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek obligimi ligjor (Ligji për Policinë, nen 31, paragrafi 2), sipas të cilës mbledhja, ruajtja, përdorimi dhe transferimi i të dhënave personale bëhet në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

19. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se përderisa veprimet e tilla policore realizohen në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk bëhet fjalë për

cenim të lirive dhe të të drejtave të njeriut. Mirëpo, në rast se veprimet policore i tejkalojnë përcaktimet e parapara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, atëherë duhet të ndërmerr masa ndëshkuese për kryerësit e veprimeve të tilla.

20. Prandaj, shikuar në këtë drejtim, Avokati i Popullit nuk vëren ndonjë pengesë në vendosjen e kamerave të trupit tek zyrtarët policorë, përderisa veprimet që kanë të bëjnë me të dhënat personale bëhen në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
21. Krejt në fund, Avokati i Popullit vlerëson se nuk përbën cenim të lirive dhe të të drejtave të njeriut një veprim apo një mjet i caktuar, i cili u shërben aktiviteteve policore, e që sipas të cilët ngrihet transparenca, llogaridhënia, integriteti, paanshmëria dhe përgjegjshmëria e zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së detyrave të tyre të përcaktuara me ligj.

  
Me nderime,  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit